



UNMIK CUSTOMS SERVICE  
SHËRBIMI DOGANOR I UNMIK-ut  
CARINSKA SLUŽBA UNMIK-a



## KORNIZA E STRATEGJISË OPERATIVE (KSO) 2008-2010

### PJESA 1: Hyrje

1. Ky dokument rregullon kornizën e strategjisë operative të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut dhe tregon se çka do të kthehet si kompensim për investimet e parave dhe besimit të publikut.
2. Synimi i kornizës së strategjisë operative është, të caktohen qëllimet dhe objektivat që realizohen nëpërmjet njësive operative, të cilat e përbëjnë Shërbimin Doganor të UNMIK-ut. Është një plan përsëritës që do të mbulojë periudhën trevjeçare të Kornizës afatmesme buxhetore dhe do të rifreskohet çdo vit.
3. Synimi kryesor i menaxhmentit të Shërbimit Doganor është që të arrijë qëllimet dhe objektivat organizative dhe në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojnë të arriturat. Menaxhmenti operativ është një punë komplekse e cila kërkon një sërë aftësish dhe njohurish, menaxhim të disiplinuar të kohës dhe si rezultat i kësaj njësitë operative udhëhiqen nga Menaxherë të lartë.
4. Menaxhmenti operativ duhen të kenë të qartë se çka kërkohet nga ata të realizojnë, të formulojnë sisteme dhe procedura dhe të organizojnë vendin e punës për ta arritur këtë. Ata janë të grupuar nën menaxhmentin e drejtorëve të cilët në mënyrë kolektive ulen si bord menaxhues nën Drejtorin Gjeneral. Secili Drejtor ka një Plan Operativ të Njesisë (PONJ).
5. Nga Shërbimi Doganor kërkohet të mbledhë 583\* milionë euro të hyra apo 75.29% e të hyrave të planifikuara nga taksat (774.3 milionë euro) dhe 65.59% e të hyrave totale (888.9 milion euro), të nevojshme për të financuar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008. Me një buxhet shpenzues prej 11,034,523 euro shërbimit do ti kushtoj të shpenzojë rreth 2 cent për çdo euro të mbledhur.

\* Plani i mbledhjes se te hyrave për Shërbimin Doganor konform ri-shikimit buxhetor te vitit 2008.

6. Planet që drejtojnë Shërbimin Doganor të UNMIK-ut dhe struktura organizative e menaxhmentit të lartë, së bashku me informatat shtesë mbi Shërbimin Doganor të UNMIK-ut, mund të gjenden në: [www.unmikcustoms.org](http://www.unmikcustoms.org)

## **Pjesa 2: Zhvillimi i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut**

1. Shërbimi Doganor është themeluar më 1999 si pjesë e UNMIK-ut dhe është e drejtë e rezervuar e PSSP. PSSP emëron Drejtorin Gjeneral i cili ka përgjegjësi statusore për të ushtruar funksionet kryesore dhe fuqitë e Doganave të UNMIK-ut të cilat janë nxjerr prej Rregullores së UNMIK-ut 2004/1 (Kodi Doganor). Është organizatë buxhetore për qëllime të buxhetit të Kosovës dhe financohet plotësisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Ndonëse nuk është pjesë e shërbimit civil të Kosovës, Drejtori Gjeneral gjatë ushtrimit të autoritetit statusor përpiket të inkorporojë praktikat dhe procedurat më të mira të shërbimit civil në administratën e Doganës.
2. Ne besojmë se është Shërbimi Doganor më i ri në botë dhe ka zhvilluar në mënyrë progresive çdo element të Shërbimit Doganor modern prej themelimit të tij, në kontrollin e të hyrave, ngritjen dhe zhvillimin e sistemeve, promovimin në komunikim dhe bashkëpunimin me komunitetin e biznesit, ndërtimin dhe profesionalizimin e kapaciteteve njerëzore, inteligjencën, hetuesinë dhe elementet anti-kontrabandë, politikën dhe njësitë ligjore së bashku me funksionet e drejtorisë qendrore.  
Ndonëse ende nuk është anëtarë i plotë në organizatat ndërkombëtare, merr pjesë në të gjitha iniciativat ndërkombëtare dhe regjionale nën programin IPA dhe iniciativës së bashkëpunimit të Evropës Juglindore (IB EJ). Po ashtu mund të përfitojë nga Organizata Botërore e Doganave (OBD) dhe ka aplikuar për status të vëzhguesit. Në këtë mënyrë Shërbimi Doganor i UNMIK-ut përfiton nga asistenca e ndërsjellë ndërkombëtare dhe asistenca e ndërsjellë ligjore dhe shkëmben praktikat dhe procedurat më të mira.
3. Shërbimi Doganor i UNMIK-ut hyn në vitin 2008 me 562 oficerët nga numri maksimal i rregulluar me kufijtë buxhetor prej 567. Nga numri i lejuar i stafit gjatë vitit 2007, 17% kanë qenë nga grupet minoritare dhe 25% femra. Përkundër planeve për të rritur shërbimin, për shkak të kufizimeve buxhetore, rekrutimi i stafit do të kufizohet me zëvendësimin e stafit të cilët e lëshojnë Shërbimin dhe do të synoj të rekrutojë minoritete si dhe persona e paaftë dhe me aftësi të kufizuara.  
Përkundër mos aprovimit të planifikimit për numër shtesë të stafit për periudhën tre vjeçare (641 veta), shërbimi doganor do të rishikojë dhe analizoj kërkesën për rritje të stafit dhe propozoj Qeverisë, me arsyetimin për nevojën për staf shtesë me qëllim që të arrijë numrin prej 591 sa ka qenë e aprovuar në të kaluarën. Krahas planifikimit dhe kërkesave të shërbimit për ngritjen e kapaciteteve, shërbimi me barrën që i është vënë si bartës kryesor në mbledhjen e të hyrave të parashikuara nga MEF, do të mundohet të rishikon edhe njëherë më në detaje kërkesat e veta në planifikimin buxhetor për të gjitha kategoritë e shpenzimeve dhe të krijoj një sistem adekuat të pagave dhe performances për stafin e shërbimit doganor, si dhe të bëjë modifikimin e shpenzimeve operative dhe zhvillimin e sistemeve dhe investimeve kapitale në përfitim të ngritjes së performances dhe efektivitetit të shërbimit në përgjithësi.
4. Organizimi dhe modeli i Doganës është shqyrtuar gjatë vitit 2007 me një strukturë të re të miratuar nga Zëvendës PSSP për Rindërtim të Ekonomisë, pas konsultimit me Qeverinë. Bordi i ri i menaxherëve nën udhëheqjen e Drejtorit Gjeneral ka hyrë në fuqi më 16 janar 06, dhe në vitin 2007 të gjitha funksionet kanë kaluar tërësisht nën menaxhim të stafit lokal dhe atë në përbërje me Drejtorin Gjeneral, Drejtorin e Zbatimit të Ligjit, Drejtorin për Operimin e të Hyrave, Drejtorin për Financa dhe Sisteme dhe Drejtorin Ligjor. Konform

planeve të administratës së UNMIK-ut për bartjen e përgjegjësive, Menaxhmenti i Shërbimit Doganor gjatë vitit 2008 do të mundohet të kyçet në përkujdesjen e fazës së tranzicionit në të gjitha fushat që inkorporohet shërbimi.

5. Prej themelimit, Shërbimi Doganor i UNMIK-ut ka pasur përkrahje nga ekspertët e CAFAO –UNMIK (ish CAM –K) misioni për asistencë teknike të Doganave (dhe më vonë të taksave), i financuar nga Komisioni Evropian. Përderisa programi i CAFAO-s është reduktuar gradualisht gjatë vitit 2007, programi për vitin 2008 do të jetë vazhdimësi dhe do të mbështesë doganën nga misioni i ri TACTA, me qëllim të vazhdimësisë në asistencën dhe zhvillimin e një sistemi ligjor stabil gjithëpërfshirës i cili siguron implementimin e qartë dhe transparent të legjislacionit doganor dhe të akcizës në përputhje me EU-në. Krijimi i bazave të njëtrajtshme për vlerësimin dhe arkëtimin e taksave përderisa të respektohen plotësisht të drejtat publike, të akterëve ekonomik dhe të zyrtarëve tatimor. Vazhdimësi e përputhjes së doganave dhe të legjislacionit direkt dhe jo direkt tatimor me EU acquis dhe shtim i mëtejme i kapacitetit administrativ për të futur në zbatim legjislacionin dhe për të luftuar korrupsionin, krimin ndërkufitar dhe evazionin fiskal.

### **Pjesa 3: Strategjia e Doganave të UNMIK-ut**

#### **1. Qëllimet**

1. Të administroj në mënyrë korrekte dhe efikase sistemin e themeluar me ligjin e doganave dhe kontrollin e taksave për mallrat e importuara dhe eksportuara nga Kosova dhe çdo çështje tjetër e cila mund të caktohet herë pas here.
2. Të mbrojë të hyrat dhe komunitetin nga efektet e dëmshme nga mashtrimet dhe kontrabandimi i mallrave komerciale, drogave ilegale dhe mallrat e tjera të ndaluara.
3. Të zhvilloj Shërbimin për të arritur plotësimin e sfidave të komunitetit të bizneseve dhe progresin krahasues kundrejt kërkesave të UE (dokumenti i Blue Print-it për Doganat) dhe Standardeve për Kosovën.
4. Të punojë bashkë dhe në sinergji me agjencitë dhe departamentet tjera të angazhuara në kufij dhe në zbatimin e taksave si dhe me TACTA dhe programet tjera të asistencës teknike ndërkombëtare.
5. Të përgjigjet dhe të marr pjesë në zhvillimin e procedurave, kapaciteteve administrative, sigurisë dhe lehtësirave tregtare përbrenda Evropës Juglindore përmes pjesëmarrjes aktive në grupet punuese të ekspertëve të themeluara përmes Komisionit Evropian dhe implementimin e rekomandimeve të aprovuara.

#### **2. Objektivat**

Objektiva 1: Mbledhja e të hyrave të duhura në kohë të duhur nga TVSH-ja në import, akciza dhe obligimet doganore. Projeksionet aktuale të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të

hyrat a aprovuara si pjese e BKK për vitin 2008 janë 583 milionë dhe janë subjekt i rishqyrtimit nga MEF-i gjatë vitit.

Objektiva 2: Promovimi i komunikimit dhe bashkëpunimit nacional me komunitetin e biznesit të Kosovës, shërbimet qeveritare dhe në aspektin ndërkombëtar me administratat e tjera Doganore në regjion dhe më gjerë, duke aspiruar statusin e vëzhguesit në Organizatën Botërore të Doganave.

Objektiva 3: Zhvillimi i kapaciteteve të tjera përbrenda shërbimit për të avancuar integritetin, zhvillimin e resurseve, politikave, kornizën ligjore, të arrijë më shumë transparencë dhe përdorë praktikë sa më të mirë.

Objektiva 4: Shfrytëzimi i fuqive dhe procedurave të Kodit Doganor dhe Kodit të Akcizave për efekt më të mirë për të përmirësuar përmbushjen dhe të lehtësojë aktivitetet ekonomike në bashkëpunim me tregtarët. Të arrihet baraspeshim adekuat ndërmjet lehtësirave tregtare dhe kontrollit, duke shfrytëzuar teknikat që fusin në veprim vlerësimin e riskut, profilizimit dhe selektivitetit.

Objektiva 5: Puna me tregtarë të cilët dëshirojnë të përmirësojnë përmbushjen e tyre duke përdorur fuqitë ligjore, ku është e nevojshme të krijohet baza nga e cila lëvizë përpara duke shfrytëzuar procedurat e Kodit Doganor.

Objektiva 6: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të zbatimit të ligjit për:

- a. parandalimin dhe zbulimin e mashtrimeve, kontrabandimin e mallrave komerciale, drogave ilegale dhe mallrat tjera të ndaluara dhe të kufizuara; dhe
- b. të hetojë dhe përndjek kundërvajtjet nën udhëheqjen e Prokurorit publik.

Objektiva 7: Implementimi i rekomandimeve të grupeve punuese të ekspertëve të themeluar nga niveli i lartë i konferencës për Doganat dhe bashkëpunimi ndërkufitar në Evropën Juglindore.

### 3. Caqet e performancës

1. Arritja e caqeve të projeksioneve për të hyrat të tremujorit, përgjigja efektive ndaj çdo ndikimi të parregullsive. Ngritja e përmbushjes së akcizave duke përcjellë implementimin e Kodit të akcizave.
2. Arritja e standardeve dhe aksioneve të kërkuara nga Plan veprimi i Bashkëpunimit Evropian pasi që ato janë zhvilluar më tutje.
3. Natyra dhe zgjerimi i masave aktuale të integritetit me perceptimin e përmirësuar të publikut për integritetin e shërbimit dhe besimin e demonstruar nga biznesi legjitim.
4. Implementimi efektiv i kundër masave për të minimizuar mundësit për mashtrim dhe kontrabandim dhe për të rritur kualitetin dhe kuantitetin e rasteve me kundërvajtje sipas standardeve të prokurorit publik.

5. Krahasimi i suksesshëm (benchmarking) kundrejt standardeve të arritshme në komunitetin e Doganor të blueprint-it.
6. Implementimet aktuale të rekomandimeve të Evropës Juglindore të grupeve punuese të eksperteve lidhur me: procedurat dhe kapacitetet administrative, dhe mënyrat për të zgjidhur çështjet për koordinimin e sigurisë dhe mbrojtjes, lehtësirat tregtare dhe luftimin e mashtrimeve.

#### **Pjesa 4: Rregullimi i Buxhetit për Shpenzime**

1. Shuma e caktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (bazuar në kufij buxhetor) për Shërbimin Doganor për vitin 2008 është €1.03 milion dhe numri i caktuar i stafit është 567, të përbërë:

|                     |                         |
|---------------------|-------------------------|
| Pagat               | 2,950,707 euro          |
| Mallra dhe Shërbime | 4,865,976 euro          |
| Shpenzime komunale  | 227,500 euro            |
| Shpenzimet kapitale | 2,990,340 euro          |
| <b>Total</b>        | <b>11,034,523 euro*</b> |

\* Buxheti i Shërbimit Doganor konform ri-shikimit buxhetor të vitit 2008.

#### **Pjesa 5: Konkluzionet e Drejtorit Gjeneral**

1. Drejtori Gjeneral sipas ligjit i përgjigjet Zëvendësit të PSSP për zhvillim ekonomik dhe rikonstruktiv dhe nëpërmjet tij tek PSSP-ja. Konsultimi me qeverinë është i domosdoshme dhe vital për sukses të shërbimit.
2. Përbushja e përmirësuar nuk do të përmirësoj vetëm të hyrat e Shërbimit Doganor por do të vendos një bazament më të mirë prej nga përbushja e taksave të brendshme dhe të ardhurat do të shërbejnë për përfitim të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Përmirësimi i përbushjes është përzierje e qasjes vullnetare me tregtarët të cilët dëshirojnë të binden dhe zbatojnë ligjin aty ku ka ngurrim kolektiv ose individual, shmangie apo evazion të përgjegjësive.
3. Shërbimi doganor është duke dëgjuar pikëpamjet e komunitetit të biznesit, se si mund të përmirësohet përbushja. Iniciativa e përbushjes tregtare vazhdon si përpjekje e bashkëpunimit të përbashkët me tregtarët me ç'rast fuqitë ligjore për veprim të lirë do të përdoren për arritjen e nivelit të kooperimit të doganës dhe biznesit e cila do të jetë unike në përvojën ballkanike.

4. Gjithmonë janë prezentë rreziqet për të hyrat dhe kërcënim ndaj shoqërisë nga krimi i organizuar dhe grupet e trafikantëve. Korrupsioni është endemik në regjion dhe ne punojmë duke u bazuar në atë se ekziston edhe përbrenda shërbimit. Në fakt, asnjë shërbim publik askund në botë nuk mund të thotë se nuk ka elemente të korrupsionit prezentë tek individët dhe ndonjëherë elemente subversive. Shërbimi Doganor ka ndërtuar një sistem efikas për luftimin e mashtrimeve dhe veprimeve kriminale dhe se zhvillimi i mëtejshëm i tij do të jetë vazhdimësi e angazhimeve tona.
5. Përgjigja jonë ndaj kërcënimeve të korrupsionit është që në mënyrë të vazhdueshme ta kontrollojmë dhe ta mbajmë nën zhvillimin e fuqishëm të sistemeve dhe procedurave për parandalim, zbulim dhe shqyrtim duke u marrë me shkakun fillestar. Të gjitha rastet e korrupsionit do t'i raportohen Prokurorit publik me pasqyrën e hetimeve dhe akuzën.
6. Kodi i rishqyrtuar i Mirësjelljes, që përfshinë parimet e deklaratës së rishkruar Arusha të Organizatës Botërore të Doganave ka hyrë në fuqi në vitin 2006 si dhe departamenti i ankesave dhe keqpërdorimeve është forcuar si pjesë e qasjes tonë anti-korrupsion dhe në mënyrën se si ne merremi me ankesa dhe keqpërdorime në përgjithësi. Ne kemi nevojë për ndihmë nga publiku dhe tregtarët për të identifikuar problemet dhe për të mundësuar ndërmarrjen e aksioneve.  
Ne shpresojmë se linja e drejtpërdrejt për të ndihmuar raportimin për shqetësimin e publikut do të përdoret edhe më shumë tani pas ngritjes së qendrës operative, përdorimin më të mirë të Sistemit të Mbyllur të Kamerave Vëzhguese (SMKV), Lexuesit Automatik të Targave (LAT) dhe ngritjen e sistemeve të reja si dhe implementimin e X-ray-ve në vendkalimet kufitare.
7. Këtë vit do të shohim vazhdimësinë e krahasimit të progresit kundrejt standardeve të UE Blueprint-it. Misioni i ri TACTA do të këshilloj dhe monitoroj progresin e kësaj detyre të rëndësishme dhe do të llogarit se çka mbetet për t'u bërë për zhvillimet e mëtutjeshme në përputhje me planet strategjike të SHDU-ut.
8. Ne mundohemi të përmirësojmë ueb faqen tonë e cila do të përmirësohet gjatë vitit 2008. Ju lutemi shfrytëzoni Ueb faqen tonë [www.unmikcustoms.org](http://www.unmikcustoms.org) dhe linjat e shërbimit nëse dëshironi të na tregoni vizionet tuaja për Shërbimin Doganor, në mënyrë që ne të marrim komente dhe të zhvillohemi në kapacitetet ekzistuese dhe zhvillimin e ideve të reja që do të lehtësonte punën tonë, shërbimin efektiv, ngritjen e performances dhe arritjen e qëllimeve, objektivave dhe caqeve të Shërbimit Doganor .

---

Naim Huruglica  
Drejtor Gjeneral